

Data 04.04.2023.

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT :

“Hidroizolim i shkollave dhe institucioneve ”

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Librazhd ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):
Nuk aplikohet ne kete rast.**

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Xhiroja mesatare vjetore per nje periudhe maksimumi deri ne 3(tre) vitet e fundit financiare , duhet të ketë një vlerë te pakten 40 % te vleres se parashikuar te kontrates, pa perfshire vleren e TVSH-se, per te cilin duhet te paraqitet vertetim leshuar nga administrata

tatimore. Kjo kerkese konsiderohet e permbushur nqs Operatoret Ekonomike arrijne vleren e xhiros minimale , ne te pakten nje vit te periudhes se kerkuar nga AK si me lart.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

2.2.2. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të viteve të fundit (2020 - 2021) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore , të konfirmuara nga ky autoritet qe te tregojne raportet midis aktivitet dhe pasivitet . Shenim: Ne respektim te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar , neni 43, pika 4, kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur nese ne bilancet e kerkuara nuk ka raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivitet.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojte vertetesine e informacionit te paraqitur ne zbatim te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", etj.

3.Aftësitë teknike dhe profesionale:

3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë minimalisht sa 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është minimalisht sa vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

(Shënim: të përcaktohen dokumentet konkrete që kërkohen për të dëshmuar përvojën e mëparshme të ngjashme me sektorin privat, të cilat janë të nevojshme dhe i shërbejnë AK për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa vlera e fondit limit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Mbeshtetur në rendesine e objektit të prokurimit, vlerën e fondit limit të venë në dispozicion, tipologjinë e punimeve të ndertimit etj.

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

3.2. Liçencat profesionale që duhet të plotësojnë pjesëmarrësit, në varësi të llojit të punimeve për këtë objekt, do të jetë:

- NP-3 A Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash.
Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- NS-4 A Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to etj. .

sipas modelit të lëshuar nga MPPT;

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, si dhe të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 18, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar si edhe Vendimin nr. 42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike, qe ushtrojne veprimtari ndertimi", pikat e licences dhe kategorite me klasifikimet perkatese caktohen duke u mbeshtetur ne punimet e parashikuara ne preventivin e objektit dhe ne vleren totale te punimeve per secilen kategori.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të k kategorinë përkatëse
NP 3	Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash	Sipas preventivit	A	Nuk e kalon vleren 20 milion leke.
NS-4	Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to etj	Sipas preventivit	A	Nuk e kalon vleren 20 milion leke

3.3. Duke vlerësuar llojin , volumet e punimeve dhe afatin e zbatimit te punimeve te vendosur nga projektuesi per kete objekt, çdo shoqëri pjesëmarrëse, duhet të ketë stafin e nevojshëm për kryerjen e këtij investimi i një punësim mesatar minimumi prej 15 (pesëmbëdhjetë) personave gjithesej (duke përfshire dhe stafin drejtues dhe teknik), për periudhen tre muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit .

a.Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj - për periudhen tre muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit .

b.Listë pagesat e punonjësve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi për periudhen tre muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit .

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punetorine dhe stafin teknike që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre “(perlllogaritja e oreve te Punes si edhe te mjeteve te nevojshme) , Kodi i Punes ne RSH , si edhe bazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt te objektit. Komisioni i perlllogaritjes se vleres se fondit limit dhe pergatitjes se dosjes teknike kane analizuar dhe perlllogaritur numrin minimal te punetorise prej 15 punonjesish mesatarisht te dosmosdoshem per realizimin e objektit te prokurimit ne nje afat kohor 30 ditesh- grafik punimesh.

3.4. Shoqëria pjesëmarrëse duhet të ketë të punësuar staf si drejtues teknik në licencë për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, **të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diploma apo licence profesionale nqs eshte rasti , si dhe të figurojnë dhe në listepagesat e shoqërisë për të gjithë periudhën e kërkuar me lart** , për periudhen tre muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit , stafi inxhinierik si më poshtë :

- 1 (nje) inxhinier Ndërtimi

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punetorinë dhe stafin teknikë që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit .

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një liste personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” bazuar në perlllogaritjen e oreve të punës , kategoritë e punimeve të përcaktuara në preventive, specifikimet teknike të objektit, detajeve të projektit dhe tipologjia e zerave të punimeve , të cilat lidhen ngushtesisht me listën e stafit teknik të kërkuar nga AK , si edhe bazuar në dosmosdoshmerinë e realizimit sa me shpejt të objektit

3.5.Duke vlerësuar rëndësinë, llojeshmerinë dhe volumi i zerave të punimeve të objektit që prokurohet, çdo shoqëri pjesëmarrëse duhet të dëshmojë që ka në stafin e saj , punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për verifikimin e punonjesve,me kontratë pune të vlefshme , të domosdoshëm për kryerjen e punimeve :

- 1 Teknik ndërtimi
- 2 shofer
- 3 specialist Hidroizolues.
- 1 punonjes në lartësi

Për shoferet e mjeteve të rënda duhet të paraqiten dëshmitë e drejtimit nga DPSHTRR (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse dhe duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme .

Sqarim: Në rastin kur O.E disponon një punëtor me më shumë se një kualifikim të çertifikuar ky punonjës do të jetë i vlefshëm për të secilin nga kualifikimet që ai disponon.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarinë e mësipërm.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punetorinë dhe stafin teknikë që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një liste personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e

prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Për miratimin e manualit teknik të cmimeve të punimeve të ndertimit dhe të analizave teknike të tyre”, bazuar në perlllogaritjen e oreve të punës , kategorite e punimeve të përcaktuara në preventive, specifikimet teknike të objektit, detajeve të projektit dhe tipologjia e zerave të punimeve , të cilat lidhen ngushtesisht me listën e stafit teknik të kërkuar nga AK , si edhe bazuar në dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt të objektit.

3.7.Pajisjet e domosdoshme për kryerjen e këtij investimi duke u nisur nga lloji dhe sasia e volumeve të punimeve dhe afati i punimeve si dhe kushtet në të cilat do të kryhet ky investim, mjetet e kërkuara janë si vijon:

Nr	LLOJI I MAKINERIVE	PRONESIA	SASIA
1.	Kamiocine deri në 3.5 ton	në pronësi ose me qera	Cope 2
2.	Vinc kulle	në pronësi ose me qera	Cope 1
3.	Skeleri (1000 m2)	në pronësi ose me qera	(1000 m2)
4.	Elektroorgano	në pronësi ose me qera	Cope 2
5.	Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtes min 10 (dhjete) ton.	në pronësi ose me qera	Cope 1

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, aktin e pronësisë, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit (të vlefshme), certifikate për transport mallrash brenda vendit nëse kërkohet sipas legjislacionit në fuqi (e vlefshme) dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, aktin e pronësisë, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme) , certifikate për transport mallrash brenda vendit nëse kërkohet sipas legjislacionit në fuqi (e vlefshme) të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit noteriale,, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- d) Per secilin nga mjetet e kerkuara te paraqiten foto ku te jete e dukshme targat e mjeteve.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Sqarim per ofertuesit : Ne respektim dhe zbatim te **Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Per Prokurimin Publik ” neni 82 dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”,neni 26 neni 39**, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake**, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe nenit 26 te VKM nr.285, date 19.05.2021. **Në çdo rast, përpara se të publikoje njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes se afateve te ankimit , autoriteti kontraktor detyrimisht do t’i kërkojë ofertuesit fitues te renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit per pikat a, b, d, dh, e, h, I, j te pikes 2 te nenit 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shoqeruese te ofertes te dorezuara ne rruge elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre “ (perllogaritja e oreve te Punes si edhe te mjeteve te nevojshme) , Kodi i Punes ne RSH , si edhe bazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt te objektit.

3.8. Analizat e cmimeve per cdo ze te preventivit te shoqeroje formularin e ofertes ekonomike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,i ndryshuar, Vendimi i KM nr. 629, date 15.07.2015 „ Per miratimin e manualit teknik te cmimit te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre“ i ndryshuar, VKM nr. 68 date 15.02.2001 „ Per miratimin e standarteve dhe kushteve teknike te projektimit dhe te zbatimit te punimeve te ndertimit „, te perditesuara , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe te paraqesin analizen teknike per cmimet me ane te te cilave do te ofertojne.

3.9. Cdo ofertues duhet të paraqesë grafikun e punimeve të firmosur dhe vulosur nga administratori. Në rast BO grafikun e punimeve duhet të jetë i firmosur dhe vulosur nga secili prej administratoreve perkates.

Grafiku i punimeve në përputhje me zërat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit, kjo në respektim të VKM nr.285, date 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

3.6. Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 9001- 2015** (e vlefshme) ose ekuivalente , certifikatën e menaxhimit mjedisor **ISO 14001-2015** (e vlefshme) ose ekuivalente, certifikatën e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë **ISO 45001-2018** (e vlefshme) ose ekuivalente.

Te gjitha certifikata e mesiperme duhet të jene të të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Çertifikatat e mësipëme kërkohen të jenë të vlefshme.

Ne zbatim të nenit 44 të VKM nr. 285, date 19.05.2021 autoriteti pranon cdo certifikatë ekuivalente/ të barasvlefshme me të, ose një dokument që provon të njëjtin informacion.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në bazë të pikës 4, të nenit të 77, neni 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika dhe neni 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

3.10. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- minimalisht 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores”, “Për sigurinë në kantier”. Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, e dhënë nga një organizem i licencuar, shqiptar ose i huaj.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punetorinë, stafin teknik dhe kerkesat e mesiperme që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

3.11. Ofertuesi duhet të dorëzojë për mallrat hidroizolues , katrama të percaktuar në preventiv objekt prokurimi Autorizim Prodhuesi, ose distributori. Në rast se do të paraqitet autorizim distributori operatori ekonomik duhet ta vertetojë këtë duke paraqitur kontratë furnizimi, letër angazhimi ose akt-marreveshje të vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës, lidhur me Kompanisë prodhuese dhe Distributorit të autorizuar i cili garanton furnizimin e Operatorit Ekonomik.

Sqarim per ofertuesit : Ne respektim dhe zbatim te **Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Per Prokurimin Publik ” neni 82 dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”,neni 26 neni 39**, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake**, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe nenit 26 te VKM nr.285, date 19.05.2021. **Në çdo rast, përpara se të publikojë njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes se afateve te ankimit , autoriteti kontraktor detyrimisht do t’i kërkojë ofertuesit fitues te renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit per pikat a, b, d, dh, e, h, I, j te pikes 2 te nenit 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shoqeruese te ofertes te dorezuara ne rruge elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Sipas specifikimeve teknike dhe relacionit bashkangjitur DST.

Njesia e Prokurimit: